

FJALA E MBYLLJES

Më lejoni që në emër të Këshillit Organizues të paraqes fjalën e mbylljes të sesionit shkencor "Shotë Galica-Heroinë e Kombit".

Në dy seancat e sotme pos fjalës së hapjes u lexuan edhe 17 kumtesa, si dhe me diskutime kontribuan mbi dhjetë studiues, njohës dhe simpatizantë të veprës së Shotë Galicës.

Me këtë rast më lejoni të shpreh keqardhjen tonë që dy kolegët tanë nga Shqipëria (Dr. Fatmira Musaj dhe Dr. Marenglen Verli), përkundër dëshirës së madhe për të dhënë kontributin e tyre në këtë session, nuk mundën të vijnë për arsye tashmë të njohura, ngase autoritetet jugosllave nuk ua dhanë vizën hyrëse për në Kosovë. Besojmë se ata do të na i dërgojnë kontributet e tyre për botim.

Në kuadër të kumtesave të lexuara u sqaruan dhe u ofruan të dhëna të reja me interes për rrethanat shoqërore dhe politike në gjysmën e parë të shekullit XX. Duke u sqaruar këto rrethana me anë të kumtesave të shumta u spikat edhe roli dhe kontributi i Shotë Galicës në Lëvizjen Çlirimtare të kohës. U fol dhe u ofruan të dhëna me interes për fëmijërinë dhe rininë e Shotë Galicës, ashtu siç u fol edhe për Shotën si prijëse e çetave çlirimtare.

Mjaft kumtesa e kontribute ofruan të dhëna për bashkëluftëtarët dhe bashkëpunorët e Shotë dhe Azem Galicës. Nuk mbeti anash as trajtimi artistik i Shotë Galicës si frymëzim i përhershëm për poetët deri në ditët e sotme, ashtu sikurse që u trajtua edhe figura e Shotë Galicës në prozën artistike dhe në tregimet popullore të Drenicës.

Kontribut të veçantë në këtë sesion shkencor dhanë edhe shumë studjues me diskutimet e tyre të cilat e plotësuan në një masë tablonë e jetës dhe të veprës së Shotë Galicës në shumë dimensione.

Përkundër faktit se në këtë sesion shkencor kush-tuar heroinës sonë kombëtare-Shotë Galicës, munguan sidomos temat që do ta trajtonin Shotë Galicën në arte si në film, dramaturgji, arte figurative apo edhe tema të tilla, të cilat do ta trajtonin vendin që zë Shota në tekstet mësimore të historisë dhe të letërsisë si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri e në trojet tjera etnike shqiptare, konsiderojmë se sesioni ishte plotësisht i sukseshëm.

Megjithatë, veprimtaria dhe kontributi i Shotë Galicës në këtë sesion shkencor u elaborua në shumë dimensione, që besojmë se është edhe një kontribut i pakontestueshëm për shkencën tonë historike. Në këtë aspekt më lejoni të konstatojë se tabllloja për Shotë Galicën, heroinë e kombit që nga dita e sotme është më e plotë.

Në fund, më lejoni që në emër të Institutit të Historisë në Prishtinë të falënderoj të gjithë autorët e kumtesave, si dhe të gjithë ata që morën pjesë dhe që kon-

tribuan me diskutime. Falënderoj edhe të gjithë pjesëmarrësit e këtij sesi. Falënderoj gjithashtu edhe z. Anton Krasniqi, i cili na siguroi lokalim dhe na mundësoi që me sukses ta realizojmë këtë aktivitet shkencor. Gjithashtu falënderoj edhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit që kontribuan në sensibilizimin e opinionit për këtë aktivitet tonin.

Mirupafshim në sesi. të tjera shkencore.